




Republika e Kosovës

Komuna Gllogoc



Drejtoria për Bujqësi Pylltari dhe Zhvillim Rural

Në kuadër të zhvillimit dhe përparimit të bujqësisë në sektorin e Pemtarisë dhe Perimtarisë Komuna e Drenasit respektivisht Drejtoria për Bujqësi Pylltari dhe Zhvillim Rural publikon këtë

REPUBLIKA E KOSOVES			
KOMUNA E GLOGOC			
GLOGOC MUNICIPALITY			
Nr. 03 / 101 2019			
Nr. Reg.	Numër	Shifra	Vlera
09	400	57795	

THIRRJE PËR APLIKIM

Për shkak të mos plotësimit të kriterëve nga thirrja publike e dt 03.05.2019 për 100 Motokultivator bëhet shpallje e thirrjes publike edhe për 11 përfitues të mundshëm të projektit në fjal, ftohen fermerët e interesuar për të aplikuar në projektin "Mekanizëm Bujqësorë – Motokultivator " për fermerët e Komunës tonë .

Implementimi i projektit do të jetë me bashkfinancim të fermerëve :

- Financimi nga Komuna 70 % dhe Financimi nga Fermeri 30 % e koston së Pajisjes Bujqësore – Motokultivatorit .

Kriteret për aplikim :

1. Fermeri duhet të jetë banor i Komunës së Drenasit ,
2. Të jetë i gatshëm të paguaj paraprakisht 30 % të koston së Motokultivatorit ,
3. Të posedoj 0.10 ha e më shumë Plantacion me Pemë ose Serrë (prej 0.05 ha) ,
4. Të ketë fuqi punëtore për shfrytëzim adekuat të këtij mekanizmi – Motokultivatori ,
5. Përparësi në kushte të barabarta kanë fermerët që nuk janë përfitues më parë të subvencioneve nga komuna dhe gjatë vitit të njëjtë fiskal nuk kanë qenë përfitues i një subvencioni për bujqësi të ndarë nga pushteti qendrorë ose ndonjë donator tjetër , fermerët të cilët jetojnë në zona rurale , të rinjët , femrat , familjet që kanë persona me nevoja të veçanta .

Dokumentet e nevojshme për aplikim :

1. Plotësimi i aplikacionit ,
2. Kopja e letërnjoftimit ,
3. Të jetë i regjistruar në librin e fermës (NIF) (përparsi fermerët që janë të regjistruar para thirrjes publike)
4. Vërtetimin e tatimit në pronë ,
5. Fletën Poseduese të tokës nga aplikuesi apo në kuadër të ndonjë familjari .

➤ Afati i aplikimit nga data 03.10.2019 deri me 18.10.2019

Vërejtje :

Dorëzimi i aplikacioneve të bëhet në Arkiv – Komunë,

Aplikacionet e pa kompletuara dhe të dorëzuara pas afatit nuk do të shqyrtohen.

Drenas 02.10.2019



Kryetari i Komunës

Ramiz Lladrovci